

TAKIMI I PARË 2022 - KOMITETI SEKTORIAL I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT

Mbledhja e Komitetit Sektorial të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit u mbajt më datë **28.04.2022**.

Mbledhja u hap me prezantimin e anëtarëve të Komitetit Sektorial, lidhur me profesionin, institucionin që përfaqësonin dhe eksperiencën e tyre në fushë. Anëtarët u njohën me sistemin shqiptar të kualifikimeve, Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve dhe instrumentet që rregullojnë trajnimin sipas sistemit të kualifikimeve, përfshirë standardet e profesioneve, standardet e kualifikimeve profesionale, procedurat dhe kriteret e vlerësimit të aftësive.

Gjatë diskutimeve u theksua rëndësia e identifikimit të nevojave të tregut për aftësi dhe studimi i këtyre nevojave.

Sekretariati Teknik theksoi se, Komiteti Sektorial do të kryente përditësimin e ofertës ekzistuese të kualifikimeve mbështetur në studimin e nevojave për aftësi.

Sekretariati theksoi se, veprimtaria e KS do të kontribuonte në nxitjen e partnerëve të biznesit për pranimin e nxënësve dhe studentëve në kryerjen e praktikave profesionale në biznes, si një domosdoshmëri e tregut. U evidentua gjithashtu se, misioni kryesor i Komitetit do të ishte validimi i standardeve të profesioneve dhe standardeve të kualifikimeve profesionale.

Mbledhja vijoi me prezantimin e funksioneve dhe rezultateve të pritshme nga funksionimi i Komitetit Sektorial si dhe rolin e Sekretariatit Teknik, fushën e veprimit, objektivat, funksionet dhe aktivitetet e tij.

Në pjesën e fundit të mbledhjes anëtarët propozuan dhe zgjodhën kryetarin e Komitetit Sektorial.